

RELACION

Ky relacion mbahet sot më datë 25.01.2024, në zbatim të urdhërit të brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr.21, datë 22.01.2024 për përgatitjen e analizës së kostos, përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i Dekorit” në Bashkinë Kuçovë dhe Njësitë Administrative.

Komisioni i është referuar DST për kontratën e “Shërbimit të Dekorit” në datë 16.07.2018 si dhe vkm nr. 113, datë 01.03.2023 “ Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Përlllogaritja e kostos përfshin:

- Preventiv përmbledhës.
- Analizë kosto nr. 1
- Analizë kosto nr. 2
- Analizë kosto nr. 3
- Analizë kosto nr. 4
- Analizë kosto nr. 5
- Analizë kosto nr. 6

Në analizën e kostos nr.1, F.V banderola me dy faqe (27 copë) gjithsej dhe alanizës së kostos nr.2, F.V flamuj për festa zyrtare (40 copë) gjithsej, nuk ka ndryshim të numrit të tyre nga vitet e kaluara.

Në analizën e kostos nr. 3, F.V vijëzim rruge për automjete dhe analizës së kostos nr .4, F.V vijëzim rruge për këmbësorë, për shkak të investimeve në infrastrukturë ne lagjen “1 Maj” dhe ne lagjen Llukan Prifti, nëpërmjet sistemit ASIG dhe matjeve në terren është bërë llogaritja e metrave lineare për vijëzimet për automjete dhe në metër katror e vijëzimeve për këmbësorë , të cilat janë shtuar në këto analiza kostoje. Konkretisht gjithsej janë llogaritur 4200 ml vijëzime për automjete dhe 540 m² vijëzime për këmbësorë në gjithë territorin e Bashkisë Kucovë.

Në analizën nr. 5, F.V tabela të qarkullimit rrugor, sipas Kodit Rrugor në R.SH, për shkak të domosdoshmërisë së vendosjes së tabelave, janë llogaritur 30 copë gjithësej.

Në alanizën e kostos nr.6, F.V mirëmbajtje të lapidarëve dhe basoreliefeve në bashkinë e Kuçovës, gjithsej janë llogaritur 7(shtatë) lapidarë dhe basoreliefe sepse kemi shtimin e 1 (një) lapidari kushtuar dëshmorëve në Njësinë Administrative Lumas.